



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Kom Dh.Shk.II.nr.432/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, nga gjyqtari individual Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Shtimes- Drejtoria per Shërbime Publike-Sektori per Inspektorat kundër debitorit Firma ndërtimore Ardhmëria Sh.p.k me seli në Shtime, me bazë juridike: përmbartimore, për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, PPP.nr.225/20 të datës 15.0.2021, jashtë seancës me datë 04.10.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Ardhmëria shpk nga Shtime, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, PPP.nr.225/20 i datës 15.01.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore Ferizaj, me Aktvendimin e atakuar, PPP.nr.225/20, të datës 15.01.2021, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit Ardhmëria shpk nga Shtime, dhe ka lënë në fuqi urdhrin e përmbartuesit privat Besnik Aliu nga Ferizaj, me numër P.nr.362/2020 i datës 15.06.2020.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i debitorit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktvendimi i shkallës së parë ashtu që të shfuqizohet në tërësi urdhëri për lejimin e përmbartimit P.nr.362/20 dt.15.06.2020 i lejuar nga përmbartuesi privat ose lënda të kthehet në rivendosje.

Në përgjigjen në ankesë të datës 03.02.2021 kreditori deklaroi se vendimi i organit kompetent i Komunës së Shtimes nr.08/68 i datës 24.03.2020 është marrë në bazë të ligjit për kundërvajtje nr. 05/L-087, neni 56 pika 1,2,3 të këtij Ligji, si dhe ligjeve aktuale në fuqi për tokat bujqësore. Andaj i propozon gjykatës që vendimi me nr. 08/68 i datës 24.03.2020 i ish udhëheqësit për Inspektoriat-

Inspektorit Sanitar në Shtime të mbetet në fuqi, të hudhet poshtë ankesa e operatorit ekonomik Ardhmëria Sh.p.k me seli në Shtime.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komuna e Shtimes- Inspektoriati Sanitar me datë 15.06.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Ardhmëria Sh.p.k me seli në Shtime, në bazë të aktit administrativ-vendimit me nr.08/68 të datës 24.03.2020, me të cilin debitori është dënuar me gjobë në shumën prej 1,000.00€.

Përmbartuesi Privat Besnik Aliu nga Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lejuar përmbartimin me urdhrin P.nr.362/2020, të datës 15.06.2020, ndërsa kundër këtij urdhri i autorizuari i debitorit ka ushtruar prapësim me datën 23.06.2020, duke theksuar se e kundërshton në tërësi ndëshkimin me arsyetimin se dokumenti në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbartimore nuk i përmbush kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, ndëshkimi në fjalë është i pabazuar dhe ka propozuar që të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit.

Gjykata Themelore në Ferizaj, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë Aktvendimin e atakuar PPP.nr.225/20 të datës 15.01.2021, me të cilin ka vendosur që ta refuzoj prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar, për faktin se aktvendimi kontestues është në tërësi i përshtatshëm për përmbartim dhe është në pajtim me nenin 27 par.1 të LPP-së. Aktvendimi 08/68 dt.24.03.2020 i plotëson kushtet ligjore nga neni 22 par.1 nënp. 1.2 dhe neni 36 të LPP-së, i njëjti përmban klauzolën e përmbartueshmërisë.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka konstatuar se vendimi i shkallës e parë është bazuar në dokument të besueshëm, te paraparë me nenin 29 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, ku përcakton se *“përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm, me tutje ky nen parasheh se “dokumenti i besueshëm, është i përshatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”*, e që në rastin konkret dokument i besueshëm është aktvendimi nr.08/68 dt.24.03.2020 për shumën e detyrimit prej 1,000.00 Euro. Andaj pretendimet ankimore të debitorit sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore, se në aktvendimin e ankimuar nuk është e qartë nëse i referohet debitorit, kjo gjykatë vlerëson qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sepse e njëjta në bazë të dokumentacionit dhe shkresave në lëndë drejtë ka arsyetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejt të drejtën materiale. Në këtë drejtim Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, dhe në këtë drejtim pretendimet ankimore të debitorit u refuzuan si të pabazuara ndërsa aktvendimi i atakuar vërtetohet.

Në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike te konstatuar ne dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me te cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit te kreditorit te caktoj dhe zbatoj përmbartimin. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbartimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përmbartimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbartimit në këtë rast.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual ne shkallë të dytë, bazohet ne dispozitën e nenit 3 par.2 te LPP me te cilën është paraparë se ne shkallen e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
Kom.Dh.Shk.II.nr.432/22 datë 04.10.2022

Gjyqtari  
Krenar Berisha